

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Je mërzitur nga kjo jetë? Dil në det"/ Shqiptari me maskë joshte emigrantët për në Angli, zbardhet skema
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/je-merzitur-nga-kjo-jete-dil-ne-det-shqiptari-me-maske-jo-shte-emigran-i103897
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 12:59:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 12:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	97ff15400c3b29cdd30c39bcecd4449284972019f14122a4c2ec359defa4b4d
TEKSTI	b7ad796a2e242b6339f0fb8a1435dff04dc74f746a0b16876be895bca99a8077
PAMJA	32a0bbbb7f5f39d014fc58dc8d44aa8e1f0d48fc20311d3343978f50f159d152

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7a6955ebb4d58810892b8ed91f17b01039e66bd6a9d6bcc6065cef1918398c2c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2b81d04eb2d7a0b950a06cfe4d4e25424c0bc0e9ce056d5f2521565ca26b7d7f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/7a6955ebb4d58810892b8ed91f17b01039e66bd6a9d6bcc6065cef1918398c2c

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **ne tshatin** renduar të **e djegur** qytetit e **bllokohet dhe** Shkodër, **te bandes** një ndjekje **Krug**
Veleshnje rrugës në **nië** Matit, ku bëhet me **Unaza** do të rrethojnë Krve... **policia në** minuta më parë. Ngjarja **së** policëve që përfundon **metr**
të Beratit! Velashnje

AKTUALITET

“Je mërzhitur nga kjo jetë? Dil në det”/ Shqiptari me maskë joshte emigrantët për në Angli, zbardhet skema

Piranjat Përditësimi i fundit 13 Shtator 2026, 14:44



TikTok ka hequr mijëra video dhe llogari që reklamoin kalimet e Kanalit Anglez, ndërsa grupet kriminale po përdorin gjuhë të koduar, emoji dhe imazhe të krijuara me inteligjencë artificiale për të shmangur kontrollin. Grupet kriminale që organizojnë kalimet me gomone drejt Britanisë po përdorin gjuhë të koduar në reklamat e publikuara në TikTok, në përpjekje për të shmangur zbulimin dhe mbylljen e llogarive të tyre.

Sipas The i Paper, kontrabandistët përdorin imazhe luanësh të krijuara me inteligjencë artificiale, emoji me “ninxha”, flamuj britanikë, varka dhe avionë, si edhe fjalë apo shprehje të koduara për të tërhequr persona që synojnë të kalojnë Kanalin Anglez.

Një zyrtar i lartë i Agjencisë Kombëtare kundër Krimit në Britani (NCA) tha se rrjetet sociale luajnë rol në udhëtimin e pothuajse të gjithë emigrantëve që mbërrijnë në Britani përmes këtyre rrugëve. Në një prej videove të identifikuar nga The i Paper, një person i dyshuar si kontrabandist shqiptar shfaqet pranë një liqeni, me maskë në fytyrë dhe tri gomone të vogla pas tij. “Je mërzhitur nga kjo jetë? Merr një varkë dhe dil në det”, thotë ai në shqip, ndërsa në sfond dëgjohet muzikë rap shqiptare. TikTok e mbylli llogarinë pasi media ia raportoi platformës.

Mijëra postime të hequra

Gjatë gjysmës së parë të vitit, TikTok hoqi 17 mijë postime dhe llogari që reklamoin kalimet, ndërsa të paktën 10 mijë prej tyre kishin origjinën në Britani, sipas të dhënave të cituara nga The i Paper. Megjithatë, reklamat vazhdojnë të shfaqen. Rrjetet e kontrabandës po promovojnë gjithashtu përdorimin e gomoneve shumë më të mëdha, të cilat mund të transportojnë deri në 230 persona në një udhëtim. Autoritetet franceze thonë se këtë vit janë regjistruar të paktën 11 kalime të tilla.

Sipas shifrave të Ministrisë së Brendshme britanike, rreth 33 mijë persona mbërritën me gomone në Britani gjatë 12 muajve deri në qershor 2026. Kjo përfaqëson një rënie prej 23 për qind krahasuar me një vit më parë. Ministria britanike për Sigurinë Kufitare dhe Azilin, Anna Turley, tha për The i Paper se videot që nxisin kalimet e rrezikshme tregojnë mënyrën se si veprojnë grupet e kontrabandës.

Sipas saj, goditja e modelit të tyre kriminal kërkon ndërhyrje si ndaj reklamimit në internet, ashtu edhe ndaj vetë organizimit të kalimeve të paligjshme.

Gjuhë e koduar për t’iu shmangur kontrolleve

The i Paper pati akses në ekipin e sigurisë së TikTok, i cili merret me identifikimin dhe heqjen e materialeve që reklamojnë këto kalime. Valiant Richey, drejtues për sigurinë në TikTok dhe ish-prokuror amerikan, tha se kontrabandistët përdorin me vetëdije referenca të tërthorta.

“Ata përdorin gjuhë të koduar dhe referenca të fshehta sepse e dinë se ne po përpikemi ta heqim këtë përmbajtje”, tha Richey. Sipas tij, TikTok bashkëpunon me institucione si NCA dhe përdor të dhënat e mbledhura nga hetimet e veta për të identifikuar rrjete llogarish të lidhura me njëra-tjetrën.

TikTok thotë se përdor teknologji, përfshirë inteligjencën artificiale, si edhe moderatorë njerëzorë për kontrollin e përmbajtjes. Nga janari deri në fund të marsit, platforma hoqi rreth 180 milionë video për shkelje të standardeve të komunitetit.

Prej tyre, rreth tre milionë lidhje me trafikimin ose kontrabandimin e njerëzve. Sipas kompanisë, 98 për qind e këtyre materialeve u hoqën përpara se përdoruesit t’i raportonin.

“Ruga drejt Anglisë me gomone”

Pavarësisht masave, materiale të reja vazhdojnë të shfaqen në rrjetet sociale. Brenda vetëm një ore, gazetarët e The i Paper gjetën dhjetëra video të personave që filmonin udhëtimet me gomone ose reklamoin rrugët drejt Britanisë. Disa prej tyre lidheshin me Shqipërinë, ndërsa të tjera me persona që udhëtonin nga Sudani përmes Evropës.

Personi shqiptar i përmendur në investigim reklamonte një udhëtim për “30 mijë lekë”, rreth 275 pound. Në një video tjetër në të njëjtën llogari shkruhej drejtpërdrejt: “Ruga drejt Anglisë me gomone”. Në komentet e disa videove, përdoruesit paralajmëronin emigrantët që të mos publikonin pamje nga udhëtimi, nga frika se materialet mund të tërhiqnin vëmendjen e autoriteteve ose medieve.

TikTok hoqi videot që iu raportuan nga The i Paper dhe bllokoi një llogari të dyshuar se i përkiste një kontrabandisti. Neil Giles, përfaqësues i organizatës kundër trafikimit Stop the Traffik, tha se

grupet kriminale përdorin edhe vete personat e trafikuar për të kryer në rrjetet e tyre tani njëra dhe tjetra. Në disa raste, sipas uj, kontrabandistët marrin kontrollin e rrjetit të tyre në rrjetet sociale për të gjetur klientë të rinj.

Nga TikTok te Telegram dhe WhatsApp

Richey tha se platformat sociale janë të rëndësishme për modelin ekonomik të kontrabandistëve, sepse u mundësojnë të gjejnë klientë. Pasi vendosin kontaktin e parë në një platformë si TikTok, kontrabandistët shpesh e zhvendosin komunikimin në aplikacione private si Telegram ose WhatsApp për të përfunduar marrëveshjen, një praktikë që konfirmohet edhe nga NCA.

Analizat e brendshme të TikTok tregojnë se kur kompania mbyll një llogari të kontrabandistëve dhe ata krijojnë një profil të ri, ky profil arrin mesatarisht vetëm rreth 3 për qind të audiencës së llogarisë së mëparshme përpara se të identifikohet dhe të hiqet.

Meta, kompania që zotëron Facebook dhe WhatsApp, si edhe Telegram, thanë se ndalojnë përmbajtjet që lidhen me trafikimin ose shfrytëzimin e njerëzve dhe se përdorin monitorim proaktiv, heqje të materialeve dhe raportime nga përdoruesit.

NCA: Rrjetet sociale po shfrytëzohen nga kriminelët

Mike Hulett, i cili drejton ekipin e NCA-së që monitoron kriminelin e organizuar të emigracionit në internet, tha se agjencia është e shqetësuar për mënyrën se si grupet kriminale shfrytëzojnë platformat sociale. Nga janari deri në fund të korrikut, NCA ndihmoi në heqjen e rreth 5,600 postimeve dhe llogarive nga TikTok, 2,747 nga Facebook dhe Instagram dhe 3,194 nga Telegram. Që nga fundi i vitit 2021, kur NCA nisi bashkëpunimin me kompanitë e rrjeteve sociale, janë hequr rreth 40 mijë llogari, postime ose faqe të lidhura me këtë aktivitet. Sipas Hulett, kalimet me gomone, të cilat rreth vitit 2018 ishin relativisht të rralla, nga viti 2021 u shndërruan në një model të organizuar kriminal.

“Strategjia jonë është të përpiqemi ta godasim këtë model, duke ua vështirësuar kriminelëve sigurimin e pajisjeve, kontaktimin e emigrantëve të mundshëm dhe organizimin e kalimeve”, tha ai.

Numri i punonjësve të NCA-së që merren me kriminelin e organizuar të emigracionit është më shumë se dyfishuar që nga fillimi i vitit 2025 dhe ka arritur në afro 800. Agjencia raporton gjithashtu se arrestimet për kontrabandë njerëzish janë rritur me 55 për qind gjatë vitit të fundit.

Hulett pranoi se eliminimi i plotë i këtyre materialeve nga interneti nuk është realist, por tha se autoritetet dhe platformat duhet të bashkëpunojnë për të kufizuar sa më shumë përhapjen e tyre. /The i Paper

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 13 Shtator14:32

[VIDEO/ Rrugë në gjendje të amortizuar pas reshjeve në fshatin Veleshnje të Beratit! Bashkia: Jemi pushim të dielën](#)

Një qytetar ka denoncuar në Piranjan news gjendjen e rënduar të rrugës në fshatin Veleshnje, Bashkia Berat, pas reshjeve të...

AKTUALITET 13 Shtator14:12

[“Si në Indi”/ Sportistët europianë denoncojnë kushtet e akomodimit në Tiranë, kritika për organizimin e Kampionatit](#)

Tirana po pret Kampionatin Europian Universitar të Sporteve Luftake, i cili ka sjellë në Shqipëri rreth 1,600 pjesëmarrës nga ...

AKTUALITET 13 Shtator14:03

[Fenelina për t'u dukur “zyrtar”? Urdhri, masa ndaj policëve dhe zyrtarëve abuzues](#)

Fenelinat apo logot e institucioneve në automjetet prej zyrtarëve apo efektivëve gjatë drejtimit jashtë orarit, përveç gjob&e...

AKTUALITET 13 Shtator13:36

[Nis verifikimi i dëmeve pas motit të keq në Elbasan, 30 banesa dhe 20 ambiente të prekura](#)

Katër grupe pune kanë nisur mëngjesin e sotëm verifikimin dhe inventarizimin e dëmeve të shkaktuara nga moti i keq i një dite...

AKTUALITET 13 Shtator13:21

[Detaje nga shpërthimi me tritol në Shkodër, autori i maskuar si shpërndarës picash](#)

Disa detaje të reja kanë dalë në dritë nga shpërthimi me tritol mbremë me 12 shtator në qendër të Shkodr&...

AKTUALITET 13 Shtator12:43

[“300 mijë euro ose të vras familjen”/ I la kushëririt një plumb dhe letër kërcënuese në derë, arrestohet 56-vjeçari në Vorë](#)

Një 56-vjeçar është arrestuar nga Policia e Tiranës, pasi dyshohet se ka kërcënuar kushëririn dhe familjarët e ti...

AKTUALITET 13 Shtator12:24

[Atentat në Mat/ Objektiv i autorëve ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba](#)

Objekti i atentatit të organizuar ditën e sotme në Mat, ku në drejtim të një makine u qëllua me 35 plumba, dyshohet të...

AKTUALITET 13 Shtator11:58

[Sekuestrohen 3 makina luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror për pastrim parash](#)

Policia e Vlorës ka sekuestruar tre automjete luksoze, të prodhimit të viteve të fundit. Gjatë verifikimeve nga kontrollet e b&eum...

AKTUALITET 13 Shtator11:49

[E rëndë/ 28-vjeçari shqiptar humb jetën në aksident tragjik në Kroaci](#)

Një aksident i rëndë trafiku ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të 7 shtatorit në zonën e Marinës, n&...

AKTUALITET 13 Shtator11:28

[FOTOLAJM/ "Fluturon" nafta në Shqipëri, çmimi i afrohet 230 lekëve për litër](#)

Nafta po shitet me çmime gjithnjë e më të larta në pikat e karburantit në vend. Në tabelën e çmimeve të nj...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 12 Shtator

[EMRI- 2.4 mln euro kokainë në trëndafila/ Kush ...](#)

Personi i arrestuar në Greqi si kreu i grupit të trafikut të kokainës nga Kolumbia përmes trëndafilave është Lulzim Cak...

AKTUALITET 12 Shtator

[Si arriti të fitonte lirinë Lulzim Caka në Shqi...](#)

Lulzim Caka është emri i personazhit misterioz të arrestuar nga policia greke si kreu i grupit kriminal shqiptar pas trafikut të 84 kg kokai...

AKTUALITET 12 Shtator

[EMRI- "Mund t'ia hiqja Rolex-in"/ Përgjimet tro...](#)

Një operacion "nën hije" dhe i paautorizuar, një ndjekje që përfundon me një aksident fatal. Cinikëria e agjent&e...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.